

STATUTI I SHOQERISE " ALTI & DENI " SH.P.K.

Shoqeria "ALTI & DENI " sh.p.k. ushtron veprimtarine e saj ne perputhje te plote me kuadrin legjistativ ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Shoqeria "ALTI & DENI " sh.p.k. eshte themeluar me date 01-05-2018.

Nepermjet vendimit te Asamblese se Pergjithshme Ortaket e Shoqerise, miratojne Statutin e ri te Shoqerise "ALTI & DENI " sh.p.k. me permbajtje si me poshte:

TE PERGJITHSHME

Ne kete Statut " Ligj " eshte Ligji nr. 9901 date 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare ". " Statuti " eshte ky Statut i Shoqerise. " Ortaket " eshte personi qe gezon kuoten e tij ne Shoqeri, ne perpjestim me kontributin qe ka dhene ne capital. " Dite e plote " ne lidhje me periudhen e nje njoftimi eshte periudha qe nuk perfshin ditet kur eshte dhene ose kur konsiderohet se eshte dhene njoftimidhe ditet per te cilen eshte dhene ose hyn ne fuqi njoftimi.

Titulli I

THEMELIMI, EMERTIMI, RREGJISTRIMI, DHE PERSONALITETI JURIDIK

NENI 1

Data e Themelimit dhe Emertimi.

1. Shoqeria "ALTI & DENI " sh.p.k. eshte themeluar me date 01-05-2018. Ky Statut miratohet me qellim, pershtatjen e oganizimit dhe funksionit te Shoqerise "ALTI & DENI " sh.p.k. ne perputhje me Ligjin Tregetar.

NENI 2

Personaliteti Juridik.

1. Shoqeria eshte person juridik shqiptar. Shoqeria gezon te drejta si çdo person juridik shqiptar, qe prej dates ne te cilen eshte themeluar e rregjistruar ne Rregjistrin Tregetar. Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjistacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat themeluese.

NENI 3

Forma e Shoqerise.

2. Shoqeria eshte organizuar ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar. (sh.p.k.)
3. Shoqeria mund ta ndryshoje formen e saj ne Shoqeri Aksionere nepermjet procedures se shnderrimit.

NENI 4

Objekti

Shoqeria "ALTI & DENI " sh.p.k. ka si Objekt te veprimtarise se saj;

Sipermarrjen ne fushen e kembimit valutor, si dhe ne dergesat dhe marrjen e parave.
Per arritjen e qellimeve shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet tregtare, financiare si dhe cdo lloj operacioni tjetër te kesaj natyre perfshire ketu dhe dhenien e garancive eventuale. Shoqeria mund te kryeje drejtperdrejt apo dhe indirekt brenda dispozitave ligjore, pjesmarrje ne shoqeri te tjera, mund te zhvilloje cdo lloj aktiviteti qe lidhet edhe ne menyre indirekte me qellimet e shoqerise dhe qe vleresohen te dobshme per arritjen e tyre. Shoqeria mund te kryeje te gjitha operacionet e tjera industriale, tregtare si dhe aktivitetin e shperndarjes apo dhe te perdorimit te ketyre sherbimeve te ndryshme per shoqerine apo dhe per te Tretet. Ushtrimin e tregetise me shumice apo pakice te artikujve te ndryshem industriale, fruta perime, dhe ne pergjithesi cdo aktivitet plotesues. Importin, eksportin e mallrave dhe pajisjeve te ndryshme elektrike te te gjitha llojeve, makinerive dhe pajisjeve te cdo lloj industrie, mjete transporti te te gjitha llojeve etj..si dhe aktivitetin e prodhimit, perdorimit dhe te shperndarjes se ketyre sherbimeve te ndryshme ne favor te te Treteve, ndertime te ndryshme dhe prodhime te materialeve te ndertimit etj., si dhe ne pergjithesi cdo aktivitet tjetër plotesues e objekt tjetër i cili nuk bie ne kundershtim me ligjin. Shoqeria mund te kryeje veprimtari ne fushen e hoteleri turizmit, mund te kryeje te gjitha operacionet industriale, tregtare, prodhuese, ndertuese, ndertime objektesh te ndryshme industriale apo civile, prodhime inertesh apo materiale ndertimi, financime te ndryshme te luajtshme apo te paluajtshme, apo dhe financime te ndryshme per te cilat Administratori i quan te nevojshem per arritjen e qellimit te shoqerise si dhe cdo objekt tjetër i cili nuk bie ne kundershtim me ligjin apo dhe me objektin e shoqerise. Shoqeria mund te kryeje administrimin e qendrave te internet cafe, perfshire dhe administrimin e aktiviteve te lidhura me te si psh: bar, sherbime fotokopje, sherbime te vogla kancelarie dhe materialeve te konsumit qe kane lidhje me informatiken dhe aktivite te tjera te ketij lloji, aktivitet perpunues te gazetave dhe periodikeve, revistave javore apo mujore, si ne menyre te informatizuar dhe ne botim te shkruar. Per kete qellim shoqeria ka te drejte te improtoje dhe eksportoje makineri dhe pajisje, te jape pune me porosi per te Tretet per sherbime te ndryshme, te ofroje dhe te kryeje sherbime apo

konsulenca si ne fushem teknike dhe ate tregetare apo etj... Kryerjen e çdo operacioni ekonomik dhe juridik, industrial e prodhues, tregetar e financiar qe lidhet drejtperdrejte ose terthorazi me objektin e veprimtarise. Brenda kuadrit te despozitave ligjore, Shoqeria do te kryeje çdo biznes te pershtatshem per arritjen e qellimit te saj themelor.

NENI 5

Kohezgjatja

1. Shoqeria "ALTI & DENI " sh.p.k. kryen veprimtarine e saj tregetare per nje periudhe kohore te pacaktuar derisa te vendoset ndryshe nga Asambleja e Pergjithshme.
2. Shoqeria do te gezoje personalitetin e vet juridik deri kur me vendim te Asamblese se Pergjithshme do te vendoset prishja e Shoqerise ose kur Shoqeria te mbaroje ne nje nga menytrat e parashikuara ne ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare "

NENI 6

Selia

1. Selia kryesore e Shoqerise do te jete me adrese : Rruga " Ali Demi " , Ambient Dyqan me siperfaqe 44 m2, Pasuria me Nr. 7/62 Z.K 8150, V26 faqe 5, Tirane, Shqiperi.
2. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Selia e Shoqerise mund te ndryshohet, mund te hapnen dege te reja apo zyra perfaqesimi te saj brenda apo dhe jashte Republikes se Shqiperise.

NENI 7

Vula e Shoqerise

Shoqeria ka vulen e saj ne te cilen eshte shenuar emri tregetar i Shoqerise "ALTI & DENI " .



Titulli II

KAPITALI

NENI 8

1. Kapitali i Shoqerise eshte i ndare ne kuota.
2. Kapitali i Shoqerise eshte ne vleren 2 000 000 (DY MILION) leke.
3. Kapitali perbehet nga 1 kuote me vlere nominale 2 000 000 (Dymilion) leke.
Fondet qe vijne nga derdhjet e parave nga palet depozitohen ne nje nga bankat shqiptare te nivelit te dyte ose ne banka jashte Shqiperise, ne nje llogari ne emer te shoqerise.
Derdhja e kuotave behet sipas menyres se meposhtme:
 - Bujar Osman Aliko, si Ortak i vetem Themelues, i perkasin 1 kuote, qe i korrespondojne 100% (njeqind) te kapitalit te shoqerise.

ADMINISTRATOR dhe Ortak i vetem i shoqerise do te jete z.Bujar Osman Aliko.

Kompetencat e Administratorit/ve jane te percaktuara ne dokumentat themelore si Akti dhe Statuti i shoqerise.

NENI 9

Kuotat dhe te drejttat e lidhura me to.

Çdo kuote jep te drejten e nje vote per te marre vendime sipas ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare ".

NENI 10

Kuotat. Fitimi dhe Transferimi I kuotave.

1. Kuotat e kapitalit te Shoqerise mund te fitohen nepermjet kontributit ne kapitalin e Shoqerise, shitblerjes, trashegimnise, dhurimit apo çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kjo kontrate duhet te behet me shkrim.
2. Ortaku qe kerkon te transferoje kuotat duhet t'ia ofroje ato paraprakisht ortakeve te shoqerise me te njejtat kushte qe do t'ia ofronte personave te trete, duke i lene nje afat 30 (tridhjete) ditor per t'u shprehur ne lidhje me oferten. Ne perfundim te ketij afati kohor

prej 30 (tridhete) ditesh, nese asnje prej ortakeve nuk ka shprehur interesim per blerjen e kuotave te ofruara , ortaku qe kerkon te beje transferimin e kuotave te tij eshte i lire qe t'i kaloje ato tek personat e trete qe jane te interesuar per blerjen e ketyre kuotave duke njoftuar 30 (tridhete) dite perpara Asamblene e Pergjithshme.

Titulli III

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 11

Asambleja e Pergjithshme, Thirrja e mbledhjes, Marrja e vendimeve, E drejta e votes.

1. Asambleja e Pergjithshme si organi kryesor i Shoqerise sipas ligjit " Per tregetaret dhe Shoqerite Tregetare ", perbehet nga Ortaket e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme thirret me shkrese jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se mbledhjes, ne adresat e percaktuara ne dispoziten " Njoftimet " me poshte.
2. Njoftimi duhet te permbaje: ditën, orën, vendin ku do te mbahet mbledhja si dhe rendin e dites. Njoftimi behet nga Administratori i Shoqerise apo nga çdo Ortak i cili perfaqeson te pakten 5% (pese) te totalit te votave ne Asamblene e Pergjithshme ne perputhje me nenin 84 te Ligjit Tregetar.
3. Asambleja e Pergjithshme duhet te thirret te pakten 1 (nje) here ne vit per te vendosur çeshtje te tilla si miratimi i bilancit dhe miratimi i raportit te auditimit te Shoqerise.
4. Mbledhjet mbahen ne seline e Shoqerise apo edhe ne çdo vend tjeter te njohur nga Ortaket e Shoqerise.

NENI 12

Kompetencat e Asamblese.

Asambleja e Pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per Shoqerine ne lidhje me çeshtjet e meposhtme:

Percaktimi i politikave tregetare te shoqerise , ndryshimin e Statutit, emerimin apo shkarkimin e Administratorit, te eksperteve kontabel apo likujdueseve, mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga Administratoret perfs hire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise, shpendarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve, kryerjen e kontroll – revizionit financiar te shoqerise me ekspert te caktuar prej saj, te vendose



per zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit, te vendose per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise apo per ceshtje te tjera te cilat jane te rendesishme per aktivitetin e shoqerise.

NENI 13

Perfaqesimi ne Asamble.

1. Ortaku mund te perfaqesohet ne mbledhje nga nje Person tjetër i Trete ose dhe nga nje Ortak tjetër i Shoqerise. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.
2. Administratori nuk mund te veproje si perfaqesues i Ortakeve ne mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme.

Titulli IV

ADMINISTRATORI

NENI 14

Administratori i Shoqerise

Shoqeria administrohet nga Administratori/et zgjidhet nga Asambleja e Pergjithshme per nje afat kohor jo me te gjate se 5 (pese) vjet. Administratori i Shoqerise mund te jete vetem person fizik.

ADMINISTRATOR i shoqerise do te jete z.Bujar Osman Aliko.

NENI 15

Te Drejtat dhe Detyrimet dhe Pergjegjesite e Administratorit.

1. Administratori ushtron kompetencat e meposhtme:
Kryen te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te Shoqerise duke zbatuar politikat tregetare te vendosuar nga Asambleja e Pergjithshme, vepron me te tretet ne emer dhe per llogari te Shoqerise Brenda kompetencave te parashikuara ne Statut apo dhe ne ligjin " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare ", kryen emerimin dhe shkarkimin nga pun ate punemarresve te Shoqerise, u jep urdhera dhe udhezime punemarresve dhe vendos sanksione ndaj tyre ne perputhje me kontraten e punes dhe rregulloren e brendshme te Shoqerise, drejton dhe organizon punen ne menyre te tille qe te siguroje suksesin e Shoqerise ne veprimtarine e saj ekonomiko – financiare, raporton

para Asamblese se Pergjithshme sa here qe Asambleja e Pergjithshme e kerkon si dhe ne rastet kur eshte I nevojshem raportimi ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimtarive te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise tregetare, zbaton Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme, paraqet ne menyre te rregullt dhe ne kohe te pershtatshme tek Asambleja e Pergjithshme raportin e administrimit, inventarin, bilancin si dhe llogarite vjetore si dhe pergjigjet per to, ushtron te drejta dhe detyrime te tjera te percaktuara nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare " .

2. Administratori eshte pergjegjes ndaj Shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjit dhe Statutit dhe per falje te kryera gjate administrimit sipas parashikimit ne ligjin nr. 9901 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare " dhe ligjeve te tjera ne fuqi.

NENI 16

Mbarimi i mandatit te Administratorit.

Mandati I Administratorit perfundon :

1. Me mbarimin e afatit te emerimit.
2. Me shkarkimin e Tij nga Asambleja e Pergjithshme.
3. Kur vete Administratori jep doreheqjen vullnetarisht.
4. Sipas menyrave te parashikuara nga ligji " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare "

Titulli V

VITI FINANCIAR, PRISHJA E SHOQERISE, DISPOZITAT E FUNDIT.

NENI 17

Viti Financiar.

Veprimet financiare mbyllen me 31 Dhjetor te çdo viti. Administratori merr masa lidhur me nxjerrjen e bilancit te hartuar conform ligjit mbi kontabilitetit dhe pasqyrat financiare.



NENI 18

Mbarimi i Shoqerise

Shoqeria mbaron :

1. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme.
2. Me hapjne e procedurave te falimentimit
3. Sipas shkaqeve te tjera te parashikuara ne ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare "

NENI 19

Njoftimet.

Njoftimi per Ortaket do te kryhen ne adresat qe secili prej tyre do te depozitoje ne Seline e Shoqerise.

NENI 20

Te Ndryshme.

1. Per ceshtje qe nuk parashikohen dhe rregullohen shprehimisht nga ky Statut do te gjendet referim ne dispozitat e Ligjit nr. 9901 date 14.04.2008 " Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare ".
2. Statuti u hartua ne 4 (kater) kopje ne gjuhen shqipe dhe me vlere te njejte juridike, nga te cilat 1 (nje) kopje dorrezohet ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit, 1 (nje) kopje depozitohet ne Seline e Shoqerise dhe nga 1 (nje) kopje u jepet Ortakeve te shoqerise.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

ALIKO Bujar

